



EVROPA

për të gjithë



FOUNDATION OPEN SOCIETY INSTITUTE
Representative Office Montenegro



Organizata e Shoqërisë Civile
HORIZONTI I RI
Ulqin



EVROPA

PËR TË
GJITHË

mbështetur nga:



Foundation Open Society Institute
Representative Office Montenegro

Botues:

Organizata e shoqërisë civile " HORIZONT I RI" – Ulqin

Tel/Fax: 030/411-969,

E-mail: ngohorizonti@t-com.me

www.ngo-horizonti.org

Për botuesin:

Nazif Veliqi

Publikimin e përgatitën:

Edin Mehmeti, Nazif Veliqi, Edina Karamanaga, Sabra Dragovoja

Përgatitja teknike:

Omer Musliçiq

Shtypi:

M Print, Podgoricë

ULQIN, maj 2009

Përmbajtja

1. Si lindi Evropa?	5
1.1 Historiku i Bashkimit Evropian	6
1.2 Traktatet	6
1.3 Shtetet	9
1.4 Simbolet e BE - së	10
2. Shtyllat e Bashkimit Evropian	12
2.1 Shtylla e parë (Komuniteti Evropian)	12
2.2 Shtylla e dytë (politika e jashtme e sigurisë së përbashkët)	13
2.3 Shtylla e tretë (Bashkëpunimi në fushat e drejtësisë dhe punëve të brendshme)	13
3. Institucionet e Bashkimit evropian	14
3.1 Këshilli i Bashkimit evropian	14
3.2 Këshilli Evropian	17
3.3 Parlamenti Evropian	18
3.4 Komisioni Evropian	20
3.5 Gjykata Evropiane e Drejtësisë	21
3.5.1 Organet ndihmëse të BE-së	22
3.5.2 Komiteti evropian ekonomik dhe social	22
3.5.3 Komiteti i rajoneve (KR)	23
3.5.4 Komiteti politik dhe i sigurisë	23
3.5.5 Banka evropiane e investimeve	24
3.5.6 Banka qendrore evropiane	24
4. Kuptimi i zgjerimit të BE-së	26
4.1 Procesi i hyrjes në BE dhe kriteret	27
4.2 Si një vend mund të anëtarësohet	27
5. Procesi i Stabilizim – Asocim (SAP)	29
5.1 Çfarë është Marrëveshja e Stabilizim – Asocim	30
6. Qytetarët e Evropës	31
7. Mali ZI dhe BE -ja	32

HYRJE

Me një dëshirë të sinqertë që t'ju njoftojmë me procesin më të rëndësishëm për të ardhmen tonë, e ky është procesi i integritimeve evropiane, Organizata e shoqërisë civile HORIZONTI i RI (*Ulqin*) hartoi një projekt përmes të cilit, rinisë së Ulqinit por edhe gjithë bashkëqytetarëve tjerë, t'iu prezantojë idenë e Evropës dhe procesin e anëtarësimit në të.

Programi edukativ me titull “EVROPA PËR TË GJITHË” dedikuar gjimnazistëve të Ulqinit, ishte i konceptuar si një cikël javor ligjëratash dhe mësimi interaktiv (që zgjati gati tre muaj), në të cilin pjesëmarrësit më nga afër u njoftuan me integritet evropiane. I tërë projekti është realizuar duke kultivuar marrëdhënie të mira ndërkulturore dhe ndëretnike, si vlera themelore të Bashkimit Evropian, por edhe të hapësirës ku ne jetojmë dhe veprojmë. Ky ka qenë edhe motivi kryesor që panelet edukative të mbahen në dy gjuhë (shqipe dhe në atë malazeze). Dhe me qëllim që me këtë temë të njoftojmë edhe publikun e gjerë, vendosëm të botojmë këtë broshurë e cila do t'u shërbejë të gjithëve si doracak për njohjen më të mirë të Bashkimit Evropian.

Duke e konsideruar procesin e Integritimeve evropiane si një proces në të cilin shteti ynë tashmë ka hedhur hapa serioz dhe i cili në të ardhmen do të jetë prioriteti kryesor në politikën e jashtme, rëndësia e informimit dhe e edukimit të publikut për këtë çështje të rëndësishme, paraqitet si një nevojë e madhe.

Nisur nga kjo, HORIZONTI I RI synon që përmes këtij publikimi në të cilin mund të gjeni informacione të shumta për Bashkimin Evropian, të plotësoj zbrazësitë dhe mungesën e informacionit në gjuhën shqipe nga kjo fushë. Ky publikim ofron një mundësi të veçantë për tu informuar mbi historikun, idenë, kornizën institucionale të Bashkimit Evropian si dhe procesin aktual të integritimit në BE nëpër të cilin po kalon Mali i Zi.

Informimi mbi hapat që Mali i Zi po ndjek në këtë proces, gjatë gjithë projektit ka pasur një theks të veçantë, sepse kemi konsideruar që me këtë temë ndeshemi shpesh në komunikimin e përditshëm, por edhe përmes mediave.

Konsiderojmë se nga realizimi i këtij projekti, komuniteti lokal ka marrë një dimension të ri nga aspekti i integritimeve evropiane. Njëkohësisht, edhe të rinjtë që seriozisht janë të interesuar për këtë temë, më lehtë dhe më të sigurtë do t'mund të kontribuojnë në të gjithë procesin. Për ne, ky do të jetë rezultati dhe përfitimi më i rëndësishëm nga ky projekt.

Në fund, duke iu falënderuar Fondacionit INSTITUTI PËR SHOQËRI TË HAPUR (Përfaqësia në Mal të Zi) i cili fuqimisht mbështeti këtë projekt, por edhe të gjithë pjesëmarrësve dhe partnerëve tjerë në projekt, shprehim dëshirën që Mali i Zi sa më parë të bëhet anëtar i Bashkimit evropian dhe që procesin e integritimit ta finalizojë në mënyrë efikase dhe cilësore, ashtu siç e meritojnë të gjithë qytetarët e tij.

Ulqin, maj 2009

Si lindi EVROPA?


Historia e Evropës dhe historia e Bashkimit Evropian nuk janë e njëjta gjë, edhe pse ka shumë pika takimi në momente të ndryshme historike. Termi “Bashkim Evropian” i përket shekullit XX, ndërkohë që termi “Evropë” daton shumë më herët. Termi “Evropë” u përdor për herë të parë gjatë civilizimit grek, por në dy kontekste: njëri mitologjik dhe tjetri gjeografik. Prej etimologjisë së këtij termi mund të ngrihen shumë hipoteza, por megjithatë fjala greke eurus do të thotë e gjerë, duke e lidhur në këtë mënyrë Evropën me hapësira të gjera territoriale.

Në aspektin mitologjik Evropa konsiderohej si një femër shumë e bukur, e gjatë dhe me sy të mëdhenj. Gjithashtu Afrikës, në atë kohë i referoheshin shpesh me emrin Libia. Siç duket qartë, emrat e kontinenteve që njiheshin atëherë (Evropa, Azia, Afrika) në të gjitha versionet janë femërore.

Kjo tendencë ka rezistuar deri në ditët tona, madje jo vetëm në lidhje me emrat e kontinenteve, por edhe të shteteve përbërëse të tyre. Nga ana tjetër, në aspektin gjeografik, në lashtësi Evropa shihej si një territor i ndarë nga dy kontinentet e tjera: Azia dhe Afrika. Evropa konceptohej si territor i kufizuar në veri nga Deti i Veriut dhe në lindje nga Ngushtica e Bosforit. Ky ishte konteksti mitologjik – gjeografik i “Evropës” përgjatë civilizimit grek. Pas Luftës së Dytë Botërore, popujt evropianë u gjendën para tri çështjeve. E para ishte ekonomike: Si mund të riparoheshin dëmet materiale dhe të ringrihej aktiviteti ekonomik në kontinentin e vjetër? Çështja e dytë ishte politike: Si mund të parandalohet rikthimi i konfliktit në Evropë? E treta ishte kulturore: Si mund të sigurohej mbijetesa dhe rilindja e qytetërimit evropian në kuadër të kërcënimeve në rritje, të cilat dukeshin se mishëroheshin në konfliktin ideologjik dhe konfrontimin ndërmjet blloqeve fituese të luftës, bllokut amerikan dhe atij sovjetik?

Historiku i Bashkimit Evropian

Gur themeli për krijimin e Bashkimit Evropian u vendos nga Ministri i Jashtëm Francez, Robert Schuman, në deklaratën e tij të 9 majit të vitit 1950, në të cilën ai parashtrroi idenë e përpunuar më parë me Jean Monnet për bashkimin e industrive evropiane të qymyrit dhe çelikut. Sipas tij, kjo do të përbënte një nismë historike për ndërtimin e një “Evrope të organizuar dhe vitale”, pa të cilën paqja në botë do të ishte e pamundur.



Robert Schuman

Bashkimi evropian është një sistem juridik origjinal i cili mbështetet në traktate të ratifikuara nga vendet anëtare. Këto traktate, përbëjnë themelin e së drejtës komunitare dhe qëndrojnë mbi legjislacionet kombëtare. Të gjitha dispozitat ligjore që miratohen nga institucionet komunitare, duhet të jenë në përputhje me këto traktate të cilët përshkohen nga disa parimet themelore (si, liria, demokracia, respektimi i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore si dhe shteti i së drejtës) dhe përcaktojnë kompetencat që vendet anëtare i delegojnë Bashkimit Evropian.

Traktati i Parisit

Gjashtë shtete evropiane – Gjermania Perëndimore, Franca, Italia, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu nënshkruan më 18 prill 1951 Traktatin e Parisit me të cilin është themeluar Bashkësia Evropiane e qymyrit dhe çelikut (ECSC). Pra, ministri francez i Punëve të Jashtme, Robert Shuman dhe ekonomisti i njohur francez Zhan Mone, që në vitin 1950 sjellin të ashtuquajturin Planin e Shumanit për themelimin e ECSC-së, gjegjësisht të vendosjes së tërë prodhimit të qymyrit dhe çelikut të Francës dhe Gjermanisë nën udhëheqjen e përbashkët, kurse organizata ka qenë e hapur edhe për shtetet e tjera evropiane. Motivi për këtë bashkëpunim francez-gjerman nuk ishte vetëm ekonomik, por edhe politik. Qymyri dhe çeliku kanë qenë degët vendimtare të industrisë së luftës, kështu që një organizatë e tillë në mënyrë efikase ka mundur t'i parandalojë konfliktet e ardhshme.

Traktati i Romës

Hapi tjetër drejt formimit të BE-së është bërë më 25 mars 1957. Gjashtë shtete në Romë nënshkruajnë të ashtuquajturin Traktati i Romës për formimin e Bashkësisë Evropiane Ekonomike (BEE). Në të njëjtën kohë është përfunduar kontrata për themelimin e Bashkësisë për energjinë bërthamore - EUROATOM. Me këtë Kontratë shtetet anëtare kanë filluar t'i zhdukën barrierat dhe të formojnë të ashtuquajturin treg të përbashkët.

Traktati i Mاستrihtit

Me Traktatin e Mاستrihtit (nënshkruar në vitin 1992 dhe ratifikuar në vitin 1993) është bërë revidimi më radikal deri atëherë i BEE-së. Me këtë traktat janë vendosur qëllimet ekonomike dhe monetare të bashkësisë, valuta e përbashkët, politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë, politika e përbashkët e mbrojtjes, futja e nënshtetësisë së Bashkësisë, bashkëpunimi i ngushtë në sferën e Gjqësisë dhe Punëve të Brendshme.

Traktati i Amsterdamit

Traktatin e Amsterdamit e kanë nënshkruar ministrat e punëve të jashtme të shteteve anëtare në tetor të vitit 1997, kurse ka hyrë në fuqi në vitin 1999. Juridikisht, Traktati i Amsterdamit përmban disa shtojca në Kontratën mbi Bashkimin Evropian dhe si e tillë nuk zëvendëson traktatet e tjera, por në mënyrë të barabartë hyn në aktet juridike të Bashkësisë. Kjo është e fundit në radhën e traktateve mbi Bashkimin Evropian.

Traktati i Shengenit

Me Traktatin e nënshkruar në qershor të vitit 1985 në Shengen (Schengen), RF e Gjermanisë, Belgjika, Franca, Luksemburgu dhe Holanda janë marrë vesh për heqjen graduale të pikave të brendshme, të përbashkëta të kontrollit kufitar dhe futjen e lirisë së lëvizjes për të gjithë personat fizikë – shtetasit e shteteve nënshkruese të Traktatit, shteteve të tjera anëtare të BE-së ose të shteteve të tjera. Traktati i Shengenit dhe konventa, së bashku me deklaratën dhe vendimet e marrura nga ana e Këshillit ekzekutiv të Shengenit, e përbëjnë të ashtuquajturin " *acquis* " të Shengenit i cili ka hyrë në tekstin e Traktatit (1997), meqenëse ka të bëjë me një pjesë të tregut të brendshëm – qarkullimin e lirë të njerëzve.

Traktati i Nicës

Ky traktat është harmonizuar në fund të vitit 2000 dhe me të janë paraparë reforma të rëndësishme institucionale të BE-së, para së gjithash mekanizmat që do të mundësojnë zgjerimin, rindarjen e votave në Këshillin Evropian, heqjen e të drejtës së vetos lidhur me disa çështje (politika e imigrimit nga viti 2004, fondet strukturale nga viti 2007) dhe mekanizmi i bashkëpunimit të forcurar.

Kushtetuta e Evropës

Kushtetuta e Bashkimit Evropian është një kontratë e re evropiane, të cilën Këshilli Evropian e ka miratuar në Bruksel më 17-18 qershor 2004. Kushtetuta paraqet hapin përfundimtar në procesin e gjatë të integrimi. Kushtetuta për Evropë paraqet një tekst të veçantë, i cili përmban katër tërësi:

- Normat themelore me të cilat definohet Bashkësia, qëllimet e saj, kompetencat, procedurat me rastin marrjes së vendimeve dhe institucionet e Bashkimit Evropian;
- Karta për të drejtat themelore të cilën Këshilli Evropian e ka miratuar në Nicë;
- Politika dhe aktivitetet e Bashkësisë, si dhe normat e marrura nga traktati, të cilat janë ende në fuqi
- Normat përfundimtare dhe procedurat e parapara për miratim dhe revidim të Kushtetutës.

Kushtetuta e Evropës është refuzuar në referendumet në Francë dhe në Holandë, në vitin 2005, për çka është nënshkruar Marrëveshja e Lisbonës, e cila në masën më të madhe paraqet versionin "e spastruar" të Kushtetutës së BE-së

Traktati i Lisbonës (Traktati reformist)

Kontrata e Lisbonës është nënshkruar më 13 dhjetor 2007, në bazë të marrëveshjes mbi traktatin reformist të BE-së. Me qëllim që të hyjë në fuqi deri në zgjedhjet për Parlamentin Evropian, gjegjësisht deri në qershor të vitit 2009, është e nevojshme që ta ratifikojnë të gjitha shtetet.



- Austria - ka hyrë në BE në janar të vitit 1995
- Belgjika - është një nga vendet themeluese të Bashkimit Evropian
- Bullgaria - hyri në BE në 1 janar 2007
- Qipro – u anëtarësua në BE në 1 maj 2004
- Republika Çeke - hyri në BE në 1 maj 2004.
- Danimarka - u anëtarësua në BE në janar të vitit 1973.
- Estonia - hyri në BE në 1 maj 2004
- Finlanda - ka hyrë në BE në janar të vitit 1995.
- Franca - është një nga gjashtë vendet themeluese të BE-së.
- Gjermania - është një nga gjashtë vendet themeluese të BE-së.
- Greqia - është bashkuar me BE në janar të vitit 1981.
- Hungaria - aderoi në BE në 1 maj 2004
- Irlanda - është bërë pjesë e BE-së në janar të vitit 1973.
- Italia - është një nga gjashtë vendet themeluese të BE-së.
- Letonia - u anëtarësua në BE në 1 maj 2004
- Lituania - aderoi në BE në 1 maj 2004
- Luksemburgu - është shteti më i vogël i BE-së, dhe themeluesi i tij
- Malta - aderoi në BE në 1 maj 2004
- Holanda - është një nga gjashtë vendet themeluese të BE-së.
- Polonia - u anëtarësua në BE në 1 maj 2004
- Portugalia - është pranuar në BE në vitin 1986.
- Rumania - aderoi në BE në 1 janar 2007
- Slovakia - aderoi në BE në 1 maj 2004
- Slovenia - aderoi në BE në 1 maj 2004
- Spanja - ka hyrë në BE në vitin 1986,
- Suedia - aderoi në janar të vitit 1995.
- Britania e Madhe - aderoi në janar të vitit 1973.

Flamuri i Evropës. Zyrtarisht flamuri i Bashkimit Evropian dhe Këshillit Evropian, përbëhet nga një rreth me dymbëdhjetë yje ngjyrë ari në një fushë të kaltër. Ai u krijua më 1955 nga Këshilli i Evropës dhe më vonë u adoptua nga BE-ja dhe Komuniteti Evropian, në vitet e 1980ta.



Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian dallojnë nga natyra dhe anëtarët. KiE-ja është një organizatë 47 anëtarësh që merret me të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit, kurse BE-ja është një union thuajse federal me 27 anëtarë të fokusuara tek integrimi ekonomik dhe bashkëpunimi politik. Sot, flamuri lidhet më shumë me Bashkimin Evropian për shkak të profilit të saj të lartë.

Qëllimi i KiE-së ishte që flamuri ta përfaqësonte tërë Evropën, dhe qysh nga adoptimi, anëtarët e KiE-së mbulojnë gati tërë kontinentin. Kjo është edhe arsyeja pse Bashkimi Evropian e adoptoi flamurin e njëjtë. Ky flamur është përdorur edhe për të pasqyruar Evropën në ngjarje sportive dhe si një simbol pro-demokratik jashtë unionit.

Himni Evropian

Në vitin 1971 Asambleja Parlamentare vendosi të propozojë miratimin e preludit Odës së Gëzimit nga simfonia e 9-të e Bethovenit si himnin Evropian. Komiteti i Ministrave dha aprovimin e tij disa muaj më vonë. Herbert von Karajan ishte ai që bëri orkestrimin e himnit, e përshtati për orkestër dhe bëri performancën e cila u përdor për regjistrimin zyrtar. Himni u lançua nëpërmjet një fushate të madhe informimi mbi Ditën e Evropës në vitin 1972. Himni i miratua gjithashtu nga Komunitetet Evropiane në vitin 1986, dukë u bërë një tjetër simbol i përbashkët për të gjithë Evropianët.

Në prill 2004 doli në shitje një CD e Këshillit të Evropës e cila përfshin versionin e parë hip hop të himnit Evropian. I titulluar "Variations", CD përfshin përshtatje të tjera të Odës së Gëzimit, në veçanti orkestrën simfonike, organo, piano (klasike dhe xhaz), kitarë rok, violinë xhaz, versioni techno dhe trance.

9 maji - Dita e Evropës

Dita e Evropës shënohet më 9 maj – data në të cilën gjatë vitit 1950 është shpallur plani i politikës franceze Rober Shuman, që u bë baza e integritit evropian. Nga viti 1986 Dita e Evropës kremtohet zyrtarisht në shtetet anëtare të BE si edhe në këto vende që janë në prag të Bashkimit Evropian ose kanë filluar negociatat për anëtarësim.


9 maji është një prej simboleve evropiane që krahas flamurit me 12 yje, himnit dhe valutës së përbashkët evropiane euron, që përbëjnë imazhin e BE. Kjo është data në të cilën para 55 vjetëve është bërë hapi i parë drejt bashkimit të përpjekjeve evropiane në një iniciativë e cila në ditët tona gjeti realizimin vet praktik në personin e BE.

Gjithçka tjetër vjen gjatë dekadave - hyrja në fuqi e marrëveshjes për themelimin e Komunitetit evropian për qymyrgurin dhe çelikut në vitin 1954, themelimi i Komunitetit ekonomik evropian në vitin 1957 dhe më në fund kthimi i tij në Bashkimin Evropian në vitin 1991

Simboli i Euros (€) është simboli valutor i përdorur për euron, është valuta zyrtare e Bashkimit Evropian (BE). Pesëmbëdhjetë shtete anëtare e kanë adoptuar, këto vende së bashku njihen si Eurozona (Austria, Belgjika, Qipro, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Malta, Holanda, Portugalia, Sllovenia, Spanja). Valuta gjithashtu përdoret në pesë shtete tjera me marrëveshje formale, ndërsa në gjashtë shtete tjera pa marrëveshje të tilla. Si rezultat, euro është valuta e vetme për mbi 320 milion Evropianë. Dizajni iu prezantua publikut nga Komisioni Evropian më 12 dhjetor 1996. Kodi ndërkombëtar tri-shkronjash (sipas ISO kodit ISO 4217) për euro është EUR. Simboli valutor i euros (€) u dizajnuar që të jetë i ngjashëm me simbolin e vjetër të përdorur nga Njësia Valutore Evropiane.

SHTYLLATE BE-SË

Sot Bashkimi Evropian ka një strukturë interesante, e cila figurativisht prezantohet si një katedrale greke në tri shtylla. Struktura e tillë është rezultat i marrëveshjeve të shteteve anëtare të arritur në Konferencat ndërkombëtare, të cilat kanë përfunduar me miratimin e Traktatit të Mاستrihtit në vitin 1992, kur është themeluar Bashkimi Evropian.



Shtylla e parë

Komunitetet Evropiane

Shtylla e parë përbëhet nga tri Komunitetet Evropiane (Komuniteti Evropian, Komuniteti Evropian i Qymyrit dhe Çelikut dhe Euroatomi). Në momentin e themelimit të BE-së, Komuniteti Ekonomik Evropian mori emrin Komuniteti Evropian. Një ndryshim i tillë synon të shprehë kalimin nga një komunitet tërësisht ekonomik në një bashkim politik. Përfshirja e të tria komuniteteve në një shtyllë të vetme nuk nënkupton ndonjë unifikim të tyre. Shtylla e parë përfaqëson juridiksionin komunitar në formën e tij më të lartë. Brenda kuadrit të Komunitetit Evropian, institucionet komunitare mund të hartojnë normat komunitare në fushat përkatëse të veprimtarisë së tyre, të cilat zbatohen direkt mbi shtetet anëtare dhe kanë epërsi ndaj së drejtës së brendshme. Në zemër të KE-së qëndron tregu i përbashkët me katër liritë e tij themelore (liria e lëvizjes së personave, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit) si dhe rregullat mbi konkurrencën.

Shtylla e dytë

Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët

Përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Bashkimit Evropian, bashkëpunimi politik ndërmjet shteteve rregullohej nga marrëveshjet e vitit 1970 “mbi Bashkëpunimin Politik Evropian” si dhe nga Akti i Përbashkët Evropian. Këto marrëveshje parashikonin konsultime të rregullta ndërmjet ministrave të jashtëm dhe kontakte të vazhdueshme ndërmjet departamenteve qeveritare. Megjithatë, të gjitha vendimet merreshin me unanimitet. Përsa u përket çështjeve të sigurisë, bashkëpunimi kufizohej vetëm në aspektet politike dhe financiare. Megjithatë, krizat ndërkombëtare të viteve '90 (Lufta e Gjirit, lufta civile në ish-Jugosllavi) treguan se instrumente të tilla të politikës së jashtme nuk ishin në gjendje t'i siguronin Bashkimit Evropian ndikimin e merituar në arenën ndërkombëtare.


Me Traktatin e Bashkimit Evropian, Kryetarët Shteteve dhe Qeverive ranë dakord të zhvillonin një politikë të jashtme dhe sigurie të përbashkët. Pjesa më e madhe e vendimeve, në kuadër të kësaj politike, merren ende nëpërmjet bashkëpunimit të shteteve. Megjithatë, janë parashikuar një sërë mjeteve të reja si, për shembull, pozicionet e përbashkëta, masat dhe veprimet e përbashkëta si dhe vendimet kuadër.

Shtylla e tretë

Bashkëpunimi në fushat e Drejtësisë dhe të Punëve të Brendshme

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve gjyqësore dhe policore të shteteve anëtare synon t'u ofrojë qytetarëve evropiane liri, siguri dhe drejtësi, duke parandaluar dhe luftuar bashkërisht krimin, racizmin dhe ksenofobinë. Bashkëpunimi gjyqësor ka të bëjë gjithashtu me lehtësimin dhe përsheptimin e bashkëpunimit në fushën e zbatimit të vendimeve penale, lehtësimin e ekstradimit ndërmjet shteteve anëtare, vendosjen e normave penale uniforme në luftën ndaj krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikut të drogës. Njëlloj si në fushën e politikës së jashtme dhe sigurisë së përbashkët, bashkëpunimi në fushën e drejtësisë dhe të punëve të brendshme zhvillohet jashtë kuadrit vendimmarrës të Komunitetit Evropian.

Institucionet e Bashkimit Evropian



Karakteristika, që të bie më shumë në sy në tërësinë e aktorëve të nivelit mbikombëtar dhe një dallim shumë i rëndësishëm me sistemet politike kombëtare është padyshim fakti, që vendimet merren në pjesën dërrmuese të tyre nga një organ i përbërë nga përfaqësues të qeverive të shteteve anëtare, Këshillit të Bashkimit Evropian (ose Këshillit të Ministrave). Dhe ne pikërisht do të fillonim me të.

Këshilli i Bashkimit Evropian

Këshilli është organi kryesor vendimmarrës i Bashkimit Evropian. Sikurse Parlamenti Evropian edhe Këshilli është krijuar nga dispozitat e traktateve gjate viteve '50. Ai përfaqëson shtetet anëtare dhe në takimet e tij merr pjesë një ministër nga secila prej qeverive të shteteve anëtare të BE-së, me varësi të natyrës së çështjeve që do të diskutohen në atë takim. Marrëdhëniet e Bashkimit Evropian me pjesën tjetër të botës mbahen nga “Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme dhe Marrëdhënieve më Jashtë”. Por një konfigurim i tillë i Këshillit ka përgjegjësi të gjëra edhe për çështje të politikës së përgjithshme, prandaj takimet e tij mund të ndiqen nga secili prej ministrave të qeverive të shteteve anëtare, sipas zgjedhjes së vetë qeverive.

Gjithsej ekzistojnë nëntë konfigurime të ndryshme të Këshillit:

- Çështjet e Përgjithshme dhe Marrëdhëniet me Jashtë
- Çështjet Ekonomike dhe Financiare (ECOFIN)

- Drejtësia dhe Punët e Brendshme
- Punësimi, Politikat Sociale, Shëndeti dhe Çështjet e Konsumatorit
- Konkurrenca (Tregu i Brendshëm, Industria dhe Kërkimet)
- Transporti, Telekomunikacionet dhe Energjia
- Bujqësia dhe Peshkimi
- Mjedisi
- Edukimi, Rinia dhe Kultura

Gjithsesi, Këshilli mbetet një institucion i vetëm. Secili prej ministrave në Këshill gëzon plotfuqishmëri. Kjo do të thotë se, deklaratimet dhe veprimet e tij janë plotësisht të afta për të angazhuar qeverinë që ai përfaqëson. Me fjalë të tjera, nënshkrimi i ministrit është nënshkrim i qeverisë që ai përfaqëson. Gjithashtu, çdo ministër i Këshillit është përgjegjës ndaj parlamentit të vendit të tij si dhe ndaj qytetarëve që ky parlament përfaqëson, duke siguruar kështu legjitimitetin e vendimeve të Këshillit.

Këshilli ushtron gjashtë funksione themelore:

1. Miraton normat komunitare. Në disa fusha të caktuara, këtë pushtet ai e ushtron në bashkëpunim me Parlamentin Evropian.
2. Koordinon politikat e përgjithshme ekonomike të shteteve anëtare.
3. Lidhë marrëveshje ndërkombëtare, në emër të Bashkimit Evropian, me shtete ose organizata ndërkombëtare.
4. Aprovon buxhetin e Bashkimit, së bashku me Parlamentin Evropian.
5. Zhvillon Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit, në bazë të direktivave të Këshillit Evropian.
6. Koordinon bashkëpunimin midis gjykatave dhe forcave policore të shteteve anëtare në Çështjet penale.

Shumica e përgjegjësive të Këshillit kanë të bëjnë me fusha të veprimit komunitar, në të cilat shtetet anëtare kanë hequr dorë nga sovraniteti i tyre duke ua deleguar pushtetin vendimmarrës organeve të BE-së. Kjo fushë veprimi përbën “shtyllën e parë” të Bashkimit Evropian. Megjithatë, dy funksionet e fundit kanë të bëjnë me fusha në të cilat shtetet anëtare nuk kanë

nga sovraniteti i tyre, por thjesht kanë pranuar të punojnë së bashku. Kjo quhet “bashkëpunim ndërqeveritar” dhe përfshin “shtyllën” e dytë dhe të tretë të Bashkimit.

Veprimtaria e Këshillit të BE-se është e organizuar si me poshtë:

- E gjithë puna e Këshillit përgatitet dhe koordinohet nga Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm (COREPER), i cili përbehet nga përfaqësuesit e përhershëm në Bruksel të të gjitha shteteve anëtare si dhe nga ndihmësit e tyre. Vete puna e COREPER-it përgatitet nga 250 komitete dhe grupe pune, të cilat përbëhen nga delegatë të shteteve anëtare.
- Presidenca e Këshillit. Secili prej shteteve anëtare kryeson takimet e tij për një periudhë gjashtë mujore, duke promovuar vendimet politike dhe legislative të Bashkimit si dhe duke realizuar kompromisin ndërmjet shteteve anëtare.
- Sekretariati i Përgjithshëm. Ky është një organ ndihmës i Presidencës dhe ka për detyrë të sigurojë funksionimin normal të punimeve të Këshillit në të gjitha nivelet.

Tabela: Numri i votave në Këshillin e BE-së

Gjermania, Franca, Italia, Mbretëria e Bashkuar	29	Austria, Suedia, Bullgaria	10
Spanja, Polonia	27	Danimarka, Irlanda, Lituania, Sllovakia, Finlanda	7
Rumania	14	Qipro, Estonia, Letonia, Luksemburgu, Sllovenia	4
Holanda	13	Malta	3
Republika Çeke, Belgjika, Greqia, Hungaria, Portugalia	12	TOTALI:	345

Këshilli Evropian

Këshilli Evropian lindi nga Samitet e Kryetarëve të Shteteve dhe të Qeverive të vendeve anëtare. Në Samitin e Parisit të mbajtur në dhjetor 1974, u vendos që këto takime të mbaheshin tri herë në vit dhe të merrnin emrin Këshilli Evropian. Në vitin 1987, Akti i Përbashkët Evropian e bëri Këshillin Evropian pjesë të strukturës institucionale të Komunitetit. Tashmë ai është pjesë e Bashkimit Evropian.

Kryetarët e Shteteve dhe të Qeverive si dhe Presidenti i Komisionit takohen rregullisht të paktën dy herë në vit. Ata shoqërohen nga Ministri i Jashtëm si dhe një Anëtar i Komisionit.



Funksioni themelor i Këshillit Evropian është përcaktimi i drejtimeve kryesore politike për integrimin Evropian. Ai e realizon një gjë të tillë duke marrë vendimet kryesore politike si dhe duke instruktuar Këshillin ose Përfaqësuesit e Shteteve Anëtare. Në këtë mënyrë, Këshilli Evropian ka drejtuar punën për bashkimin ekonomik dhe monetar, zgjedhjen e drejtpërdrejtë të parlamentit si dhe një numër aplikimesh për aderim.

Parlamenti Evropian

Origjina e Parlamentit Evropian fillon në vitet 50-të me traktatet themeluese. Parlamenti Evropian përbëhet nga 730 deputetë, të cilët zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë nga qytetarët e shteteve anëtare. Kjo do të thotë se Parlamenti Evropian gëzon legjitimitet demokratik dhe se është i vetmi organ përfaqësues i qytetarëve të Bashkimit. Zgjedhjet parlamentare mbahen një herë në pesë vjet dhe të drejtën e votës e gëzon çdo qytetar evropian që është regjistruar si votues. Përsa i përket zgjedhjes në mënyrë të drejtpërdrejtë, anëtarët e Parlamentit, sipas traktateve themeluese “janë përfaqësues të popujve të shteteve që bëjnë pjesë në Komunitete”. Megjithatë, për një kohë të gjatë ata kanë qenë delegatë të shteteve anëtare dhe zgjidheshin sipas procedurave të veçanta nga secili shtet. Një mënyrë të tillë zgjedhjeje nuk siguronte përfaqësim të mjaftueshëm të grupeve opozitare të parlamenteve të shteteve anëtare, duke çuar kështu në një “deficit demokratik”. Në vitin 1976, Këshilli nxori një vendim lidhur me zgjedhjen e përfaqësuesve në Parlament me votim të përgjithshëm dhe direkt. Zgjedhjet e para të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta janë mbajtur në vitin 1979. Që prej asaj kohe, Parlamenti ka shprehur vullnetin politik të 374 milionë qytetarëve të Bashkimit dhe ka përfaqësuar interesin e tyre në marrëdhënie me institucionet tjera të BE-së. Parlamenti Evropian i zhvillon punimet e tij në Francë, Belgjikë dhe Luksemburg. Sesionet plenare mujore, në të cilat merr pjesë çdo euro deputet, zhvillohen në Strasburg, qytet i cili konsiderohet edhe selia e Parlamentit Evropian. Takimet e komiteteve parlamentare dhe çdo takim plenar shtesë zhvillohet në Bruksel, ndërsa Luksemburgu është qendra e administratës së Parlamentit (Sekretariati i Përgjithshëm).



Tabela: Parlamenti Evropian – përfaqësimi sipas shteteve

SHTETI	Numri i anëtarve	SHTETI	Numri i anëtarve
Gjermania	99	Bullgaria, Austria	18
Britania e Madhe Franca, Italia	78	Sllovakia, Danimarka, Finlanda	14
Spanja Polonia	54	Irlanda, Lituania	13
Rumania	35	Letonia	9
Holanda	27	Sllovenia	7
Greqia, Belgjika, Republika Çeke, Hungaria, Portugalia	24	Estonia, Qipro, Luksemburgu	6
Suedia	19	Malta	5
TOTALI:		785	

Parlamenti ushtron tri funksione themelore:

1. Ai ushtron pushtetin legjislativ në bashkëpunim me Këshillin. Fakti që është një organ i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë bën që Parlamenti të jetë garanti kryesor i legjitimitetit të së drejtës evropiane.
2. Këshilli i BE-së dhe Komisioni Evropian janë të detyruara të kërkojnë mendimin e Parlamentit, përpara se të adoptojnë një akt legjislativ, sa herë që Traktatet e parashikojnë shprehimisht një gjë të tillë. Konsultime të tilla mund të jenë edhe opcionale.
3. Parlamenti ushtron kontroll demokratik mbi të gjitha institucionet e BE-së, veçanërisht mbi Komisionin. Ai gëzon të drejtën për të pranuar ose refuzuar emërimin e Komisionarëve; mund të paraqesë emocion mosbesimi ndaj Komisionit në tërësi dhe Komisioni është i detyruar t'u përgjigjet pyetjeve të Parlamentit.

Ai ushtron, në bashkëpunim me Këshillin, pushtetin mbi buxhetin e BE-së, duke ndikuar kështu mbi shpenzimet e Bashkimit. Parlamenti gëzon të drejtën të miratojë ose të rrëzojë buxhetin në tërësi.

Veprimtaria e Parlamentit ndahet në dy faza kryesore:

- Përgatitja e sesioneve plenare. Kjo bëhet nga anëtarët e Parlamentit në komisionet parlamentare të cilat janë të specializuara në fusha të veçanta të aktivitetit të Bashkimit. Çështjet për debat diskutohen edhe nga grupet politike.

- Sesionet plenare. Gjatë këtyre sesioneve Parlamenti shqyrton propozimet legislative si dhe voton dhe propozon amendamente përpara së të votojë tekstin në përgjithësi.

Në veprimtarinë e Parlamentit Evropian bëjnë pjesë edhe “komunikimet” me Këshillin dhe Komisionin si dhe seancat e pyetjeve lidhur me gjendjen e Bashkimit dhe situatën në botë.

Komisioni Evropian

Komisioni është një organ i pavarur politikisht i cili përfaqëson dhe mbron interesat e Bashkimit Evropian në tërësi. Ai përbën mekanizmin drejtues të BE-së. Komisioni Evropian përbëhet nga 25 anëtarë të cilët emërohen një herë në pesë vjet, pa kaluar 6 muaj nga data e zgjedhjeve për Parlamentin Evropian.

Procedura e emërimit është e tillë:

- Qeveritë e shteteve anëtare bien dakord mbi emrin e personit që do të drejtojë Komisionin për pesë vjetët e ardhshme.
- Presidenti i Komisionit zgjedhë, në bashkëpunim me qeveritë e shteteve anëtare, anëtarët e tjerë të Komisionit.
- Parlamenti Evropian aprovon përbërjen e Komisionit të ri, në tërësi. Në rast se aprovohet, Komisioni fillon nga puna janarin e ardhshëm.

Selia e Komisionit Evropian është në Bruksel, por ai ka një numër zyrash në Luksemburg, përfaqësi në të gjitha shtetet anëtare të BE-së si dhe delegacione në disa prej kryeqyteteve të botës.



Komisioni Evropian ushtron katër funksione themelore:

1. Propozon aktet normative në Parlament dhe në Këshill;
2. Administron dhe zbaton politikat e BE-së si dhe buxhetin;
3. Është “gardiani” i Traktateve (së bashku me Gjykatën e Drejtësisë);
4. Përfaqëson Bashkimin Evropian në arenën ndërkombëtare.

Vetë Komisioni vendos fushën e veprimtarisë të secilit komisionar si dhe shpërndarjen e përgjegjësi në rast se është e nevojshme. Staf i Komisionit është i organizuar në departamente, të njohura ndryshe edhe si “Drejtori të Përgjithshme”. Secila prej këtyre drejtorive është përgjegjëse për një fushe të veçantë të aktivitetit të BE-së dhe kryesohet prej një Drejtori të Përgjithshëm, i cili është përgjegjës përpara njërës prej komisionarëve.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë

Gjykata e Drejtësisë është krijuar në vitin 1952 me Traktatin e Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut. Detyrë e saj është të sigurojë që e drejta e BE-së të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë uniforme në të gjitha shtetet anëtare. Gjithashtu, Gjykata ka pushtetin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve gjyqësore ndërmjet shteteve anëtare, institucioneve të Bashkimit, personave fizike dhe juridike.

Gjykata është e përberë nga një gjyqtar prej secilit shtet anëtar, duke siguruar, në këtë mënyrë, përfaqësimin e sistemeve ligjore të të gjithë shteteve anëtare të BE-së. Gjykata ndihmohet nga 8 “avokatë të përgjithshëm”, të cilët kanë për detyrë të japin mendimin e tyre për çështjet që shtrohen për zgjidhje përpara gjykatës. Mendimet e tyre jepen publikisht dhe duhet të jenë të paanshme. Gjyqtaret dhe avokatet e përgjithshëm emërohen me marrëveshje të përbashkët të të gjithë shteteve anëtare, për një mandat gjashtë-vjeçar, i cili mund të ripërtërihet me një ose dy periudha të mëtejshme tre-vjeçare.

Çështjet kryesore që shtrohen për zgjidhje përpara Gjykatës:

1. kërkesa për gjykim paraprak;
2. procedimi për shkelje të detyrimeve që rrjedhin nga traktatet;
3. procedimi për anulim të një vendimi;
4. procedimi për mosveprim.

Për ta ndihmuar Gjykatën e Drejtësisë për të zgjidhur numrin e madh të çështjeve që shtrohen përpara saj, si dhe për t'u siguruar një mbrojtje më të mirë ligjore qytetareve të Bashkimit, në vitin 1989 u krijua “Gjykata e Shkalles së Parë”. Kjo gjykatë është përgjegjëse për zgjidhjen e një numri të caktuar çështjesh, në mënyrë të veçante të atyre që paraqiten nga individët dhe çështjet që kanë të bëjnë me raste të konkurrencës së pandershme midis ndërmarrjeve.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë dhe Gjykata e Shkalles së Parë kanë nga një President, të zgjedhur ndërmjet gjyqtareve për një mandat tre-vjeçar.

Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social

Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social u krijua me Traktatin themelues të Komunitetit Evropian Ekonomik në 1957 për të përfaqësuar interesat e grupeve të ndryshme ekonomike dhe sociale. Përbëhet nga 222 anëtarë që ju përkasin tri kategorive: nëpunësve, punëtorëve dhe përfaqësuesve të llojeve të veprimtarive të veçanta (si fermerët, artizanët, bizneset e vogla dhe industria, profesionet, përfaqësuesit e konsumatorëve shkencëtarët dhe mësuesit, kooperativistët, familjet, lëvizjet për mjedisin).

Anëtarët emërohen me vendim unanim nga Këshilli me një mandat 4-vjeçar të ripërsëritshëm.

Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social këshillohet përpara se të miratohen shumë instrumente që kanë të bëjnë me tregun e brendshëm, arsimin, mbrojtjen e konsumatorit, mjedisin, zhvillimin rajonal dhe çështjet sociale. Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social mund të japë dhe mendime me iniciativën e vet. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit (maj 1999), Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social duhet të këshillohet për disa çështje (politikën e re të punësimit, legjislacionin e ri për punët sociale, shëndetin publik, mundësi të barabarta).

Gjithashtu, këshillimi i Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social mund të kërkohet nga vetë Parlamenti Evropian. Traktati i Nicës i miratuar në dhjetor 2000 nuk e ndryshoi numrin dhe shpërndarjen e vendeve të Shteteve Anëtare në Komitet. Megjithatë, e drejta për anëtarësi u qartësua: KEES përbëhet nga “përfaqësues të kategorive të ndryshme të veprimtarive ekonomike dhe shoqërore” (neni 257 i Traktatit të Komunitetit Evropian)

Komiteti i Rajoneve (KR)

I krijuar me Traktatin e Mاستrihtit në vitin 1992, Komiteti i Rajoneve përbëhet nga 222 përfaqësues të autoriteteve lokale dhe rajonale të emëruar nga Këshilli për katër vjet në bazë të propozimeve të Shteteve Anëtare. Ky Komitet konsultohet nga Këshilli, Parlamenti dhe Komisioni në fusha që prekin interesat lokale dhe rajonale, si arsimi, rinia, kultura, shëndetësia dhe kohezioni social dhe ekonomik.

Komiteti i Rajoneve mund të japë mendime edhe me iniciativën e vet. Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdimit (maj 1999), Komiteti duhet të konsultohet për një gamë të gjerë fushash, si: mjedisi, fondi social, formimi profesional, bashkëpunimi ndër kufitar dhe transporti.



Traktati i Nicës (e miratuar në dhjetor 2000) nuk e ndryshoi numrin e shpërndarjes së vendeve nga Shteti Anëtar në Komitetin e Rajonit. Duke pasur parasysh zgjerimin, Traktati parashikon që në të ardhmen numri i anëtarëve të mos kalojë numrin 350. Për sa i takon të drejtës për t'u zgjedhur për anëtarësi, Traktati parashikon qartë që anëtarët duhet të kenë mandat zgjedhor të autoritetit lokal apo rajonal ose të jenë politikisht të zgjedhur për një asamble të zgjedhurish.

Komiteti Politik dhe i Sigurisë

Komiteti Politik dhe i Sigurisë zëvendëson Komitetin Politik, por ndjek zhvillimet ndërkombëtare në fushën e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS), ndihmon në përcaktimin e apolitikave dhe monitoron zbatimin e tyre. Nën autoritetin e Këshillit, ai është përgjegjës për kontrollin politik dhe drejtimin strategjik të operacioneve të menaxhimit të krizave. I përbërë kryesisht nga përfaqësues kombëtarë, Komiteti Politik dhe i Sigurisë është në thelb të veprimtarive të menaxhimit të krizave. Për të siguruar funksionimin e tij sa më të mirë, ai mbështetet nga Grupi Politik-Ushtarak, Komiteti për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave, Komiteti Ushtarak (KU) dhe Stafi Ushtarak (SU).

Banka Evropiane e Investimeve.

Banka Evropiane e Investimeve, e krijuar nga Traktati i Romës, është institucioni financiar i Komunitetit. Detyrat e saj kontribuojnë në zhvillimin e ekuilibruar të Komunitetit me anë të integritimit ekonomik dhe kohezionit social.

Aksionarët e Bankës Evropiane të Investimeve janë Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian. Banka administrohet nga Bordi i Guvernatorëve, që përfshin 15 ministrat e financave. Banka Evropiane e Investimeve gëzon personalitet juridik dhe është e pavarur nga ana financiare. Siguron financim afatgjatë për projekte praktike për të cilat është siguruar mbështetje ekonomike, teknike, mjedisore dhe financiare. Banka Evropiane e Investimeve jep kredi veçanërisht nga burimet e fituara nga tregjet kapitale, të cilave u shtohet kapitali i aksionarëve. Gjatë periudhës 1994 dhe 1999 transporti, telekomunikacioni, energjia, uji, arsimi dhe sektori i trajnimit ishin për fituesit kryesorë.

Në mars 2000, përfundimet e Këshillit Evropian të Lisbonës kërkuan forcimin e përkrahjes për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME). “Grupi-Banka Evropiane e Investimeve”, që përfshin Bankën Evropiane të Investimeve dhe Fondin Evropian të Investimeve, u krijua për të rritur konkurrencën evropiane. Me anë të iniciativës “Inovacion 2000”, nxitet sipërmarrja, novacioni dhe përdorimi optimal i burimeve njerëzore, duke dhënë kredi afatmesme, garanci bankare, si dhe duke financuar veprimtari të sipërmarrjes së kapitalit. Banka Evropiane e Investimeve përkrah strategjitë e para-aderimit të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe menaxhon dimensionin financiar të marrëveshjeve të përfunduara sipas ndihmës evropiane për zhvillim dhe politikat evropiane të bashkëpunimit.

Banka Qendrore Evropiane

Banka Qendrore Evropiane çon përpara politikën monetare të Bashkimit Evropian, kryen veprimet e këmbimit dhe garanton funksionimin korrekt të sistemit të pagesave. Me kalimin në monedhën e përbashkët si dhe shtrirjen e një politike ekonomike evropiane gjithnjë e më unike, roli i Bankës Qendrore Evropiane është rritur gjithnjë e më shumë. Selia e saj ndodhet në Frankfurt.



Bashkimi Ekonomik dhe Monetar.

Bashkimi Ekonomik dhe Monetar paraqet procesin e harmonizimit të politikës ekonomike dhe monetare të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian me synim prezantimin e një monedhe të vetme, Euron. Bashkimi Ekonomik dhe Monetar ishte subjekt i njërës prej dy Konferencave Ndërqeveritare që i përfunduan diskutimet e tyre në Mاستriht, në dhjetor 1991.

Traktati parashikon që Bashkimi Ekonomik dhe Monetar të arrihej me tri faza:

- faza e parë (1 korrik 1990 - 31 dhjetor 1993); lëvizja e lirë e kapitalit ndërmjet Shteteve Anëtare, bashkëpunim i ngushtë i politikave ekonomike dhe bashkëpunim i ngushtë ndërmjet bankave qendrore.
- faza e dytë (1 janar 1994 - 31 dhjetor 1998): konvergjenca e politikave ekonomike dhe monetare të Shteteve Anëtare (për të siguruar stabilitet të çmimeve dhe financa të qëndrueshme publike), krijimi i Institutit Evropian Monetar dhe i Bankës Qendrore Evropiane në vitin 1998.
- faza e tretë (nga 1 janari 1999): përcaktim i pakthyesëm i kursit të këmbimit valutor dhe prezantim i një monedhe të vetme në tregjet e valutave të huaja dhe pagesave elektronike të ndjekur nga prezantimi i kartëmonedhave dhe monedhave euro nga 1 Janari 2002.

Faza e tretë e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar filloi në 11 Shtetet Anëtare që u bashkuan dy vjet më vonë se Greqia. Tri Shtete Anëtare nuk e kanë miratuar monedhën e vetme: Britania e Madhe dhe Danimarka, të cilat përfituan nga një klauzolë e mospjesëmarrjes, ndërsa Suedia nuk i plotëson të gjitha kriteret në lidhje me pavarësinë e bankës së saj qendrore.

Në 1 Janar 2002, kartëmonedhat dhe monedhat euro u prezantuan në Shtetet Anëtare, duke zëvendësuar gradualisht valutën vendase (valuta “trashëgimie”). Në 28 shkurt 2002, përfundoi faza kalimtare e qarkullimit të dyfishtë të valutave. Euro tani është valuta e vetme për më shumë se 300 milion evropianë. Sfidat që përballen me suksesin afatgjatë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar janë konsolidimi i vazhdueshëm buxhetor dhe bashkëpunimi i ngushtë i politikave ekonomike të Shteteve Anëtare.



Kuptimi i Zgjerimit të BE-së

Zgjerimi është njëri nga instrumentet më të fuqishëm të politikave të Bashkimit Evropian. Përkrahja e BE-së u ka ndihmuar vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore të transformohen në demokraci moderne e funksionale. Së voni ajo ka frymëzuar reformat me ndikim të gjerë në vendet kandidate dhe vendet e mundshme kandidate. Të gjithë qytetarët Evropianë kanë dobi nga fqinjësia me demokraci të qëndrueshme dhe ekonomi të përpaparuar tregu. Zgjerimi është një proces i menaxhuar me kujdes, i cili ndihmon transformimin e vendeve të përfshira, duke zgjeruar kështu paqen, stabilitetin, prosperitetin, demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit në gjithë Evropën.



6 anëtarë themelimi: Belgjika, Gjermania, Franca, Italia, Luksemburgu, Holanda

6

Zgjerimi drjet veriut:
1973 Danimarka, Britania e Madhe, Irlanda

9

Zgjerimi drejt jugut:
1981 Greqia
1986 Portugalia, Spanja

12

Zgjerimi EFTA:
1995 Finlanda, Austria, Suedia

15

Zgjerimi drejt lindjes:
2004 Estonia, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia, Sllovenia, Çekia, Hungaria, Qipro
2007 Bullgaria Rumania

27

Procesi i hyrjes në BE dhe Kriteret

Sipas Marrëveshjes për Bashkimin Evropian, secili vend i Evropës mund të aplikojë për anëtarësim, nëse respekton parimet e lirisë, demokracisë, të drejtat e njeriut e liritë themelore, si dhe sundimin e ligjit. Hyrja megjithatë mund të pasojë vetëm nëse secili vend evropian përmbushë të gjitha kriteret për anëtarësim, të njohura edhe si Kriteret e Kopenhagës. Këto Kritere janë vënë nga Këshilli Evropian në Kopenhagë më 1993:

- Kriteret politike: institucione të qëndrueshme që garantojnë demokraci, sundim të ligjit, të drejtat e njeriut si dhe respektim të pakicave dhe mbrojtjen e tyre.
- Kriteret ekonomike: një ekonomi funksionale tregu, si dhe aftësia për t'u përballur me konkurrencën dhe fuqinë e tregut në BE;
- Kapaciteti për t'i marrë përsipër obligimet e anëtarësimit, përfshirë këtu edhe ndjekjen e objektivave për një union politik, ekonomik dhe monetar.

Kritereve të Kopenhagës i është shtuar edhe një kriter nga Këshilli Evropian në Madrid, më 1995:

Miratimi i Acquis Communautaire (i tërë legjislacionit Evropian) dhe vënia efikase e tij në jetë përmes strukturave adekuate administrative dhe juridike.

Veç kësaj, Bashkimi Evropian duhet të jetë në gjendje që të pranojë anëtarë të rinj, kështu që ai rezervon të drejtën që të vendos kur është i gatshëm t'i pranoj ata.

Si një vend mund të anëtarësohet në BE?

Secili vend që dëshiron të hyjë në BE i dërgon aplikacionin për anëtarësim Këshillit, i cili më pastaj i kërkon Komisionit që të vlerësojë aftësinë e vendit konkurrues për t'i përmbushur kushtet e anëtarësimit. Nëse Komisioni jep mendim pozitiv dhe Këshilli pajtohet njëzëri, atëherë çelen zyrtarisht bisedimet për anëtarësim ndërmjet vendit kandidat dhe vendeve anëtare të BE-së.

Strategjia e para-anëtarësimit

Strategjia e para-anëtarësimit është e menduar që t'i përgatisë vendet candidate për anëtarësim. Kjo mbulon këto korniza dhe instrumente:

- Marrëveshjet e Evropës / Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit
- Partneritetet për Anëtarësim / Partneritetet Evropiane
- Ndihma e para-anëtarësimit
- Bashkëfinancimi prej Institucioneve Ndërkombëtare Financiare
- Pjesëmarrja në Programet e BE-së, Agjencitë dhe Komisionet
- Programi Kombëtar për miratimin e Acquis-it
- Raporte të rregullta të përparimit (progress reports)
- Dialogu Politik dhe Ekonomik

Negociatat

Hapi i parë në negociata është e ashtuquajtura “shoshitje”. Kjo është një kontrollim analitik i Acquis-it (legjislacionit evropian) për t'ua shpjeguar atë vendeve candidate dhe për t'i identifikuar fushat ku mund të ketë probleme, në mënyrë që ato të adresohen.

Monitorimi

Komisioni e mbanë Këshillin dhe Parlamentin të informuar për përgatitjet e vendit kandidat për anëtarësim me anë të “Raporteve Monitoruese”. Këto Raporte shërbejnë edhe për t'i udhëzuar vendet candidate në përgatitjet e tyre. “Raporti i Gjithanshëm Monitorues” shërben si bazë për Komisionin që të vendosë për ndonjë masë të mundshme mbrojtëse.

Procesi i ratifikimit dhe hyrja në BE

Pasi që të përbyllet negociatat, rezultatet futen në projekt-Marrëveshjen për Hyrje, për të cilën merren vesh Këshilli dhe vendi kandidat. Ajo më pas i dërgohet Komisionit dhe Parlamentit Evropian. Secili vend anëtar dhe vendi që hyn në BE duhet ta ratifikojnë atë, sipas procedurave kushtetuese në vendet e tyre. Kur procesi i ratifikimit të përbyllet dhe Marrëveshja të hyjë në fuqi, atëherë vendi kandidat bëhet vend anëtar.

Procesi i Stabilizim-Asocimit (PSA)

Procesi i Stabilizim-Asocimit (PSA) është korniza e politikave të Bashkimit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor, gjatë gjithë rrugës deri në anëtarësimin e tyre të plotë.

Partneriteti ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor është në interes të të gjithë partnerëve: paqe, stabilitet, liri, siguri, drejtësi, prosperitet, cilësi jetese për BE-në dhe për vendet e Ballkanit Perëndimor.

PSA ndjek tri qëllime, respektivisht stabilizimin dhe një tranzicion të shpejtë në një ekonomi tregu, promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe perspektivën evropiane. Ky proces u ndihmon vendeve të rajonit që të ndërtojnë kapacitetet e tyre për t'i miratuar dhe vënë në jetë standardet evropiane, përfshirë *acquis-in* dhe standardet ndërkombëtare.

PSA bazohet në partneritetin progresiv, në të cilin BE ofron një përzierje të koncesioneve tregtare, ndihma ekonomike dhe financiare (Programi CARDS) dhe marrëdhënie kontraktuale (Marrëveshjet për Stabilizim-Asociim). Secili vend ecën përpara varësisht prej përmbushjes së zotimeve nga korniza e PSA. Raportet Vjetore të Përparimit vlerësojnë se sa janë të gatshme vendet e Ballkanit Perëndimor të afrohen me BE-në.

Pas Qasjes Rajonale të BE-së për Ballkanin Perëndimor të vitit 1997, Komisioni Evropian në vitin 1999 përcaktoi themelet për të lëvizur kah një vizion më ambicioz për zhvillimin e rajonit – Procesin e Stabilizim-Asociimit. Instrumentet e tij janë formuluar në Samitin e Zagrebit në nëntor të vitit 2000. Samiti i Selanikut në qershor të vitit 2003 pasuroi PSA me elemente të frymëzuar nga procesi i zgjerimit, kështu që të mundë t'i përmbushë më mirë sfidat e reja. Në Agjendën e Selanikut u futën një varg instrumentesh të reja për të mbështetur procesin e reformave në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe t'i shpie ato më afër BE-së. Instrumentin me ndikim më të madh nga to janë Partneritetet Evropiane të inspiruar nga Procesi i Anëtarësimit. Pakoja e parë e Partneriteteve Evropiane ishte aprovuar më 2004, duke identifikuar prioritetet afatshkurta dhe afatmesme, që vendet duhet t'i adresojnë. Partneriteti Evropian do t'i ndihmojë vendet e Ballkanit Perëndimor në reformat dhe përgatitjet për anëtarësim në të ardhmen.

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë perspektivë për anëtarësim në BE – objektiv ky i përkrahur nga Këshilli Evropian në Feira në qershor të vitit 2000, dhe i konfirmuar në Selanik në qershor të vitit 2003. Këshilli i Evropës në qershor të vitit 2005 i ka konfirmuar qartë këto zotime.

Kroacia dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, të cilave u është dhënë statusi i vendeve candidate, mbesin pjesë e PSA.

Vendet tjera të Ballkanit Perëndimor janë vende të mundshme kandidatë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia përfshirë Kosovën sipas Rezolutës 1244 të KS të KB.



Në janar të vitit 2006, Komisioni Evropian miratoi një Komunikatë për “Ballkanin Perëndimor në rrugën drejt BE-së: Konsolidimi i stabilitetit dhe rritja e Prosperitetit”. Komunikata vlerëson përparimin e bërë që nga Samiti i Selanikut, si dhe përcakton masat konkrete për të përforcuar politikat evropiane dhe instrumentet e tij për Ballkanin Perëndimor.

Në komunikatën e marsit 2008 mbi Ballkanin Perëndimor “Rritja e perspektivës evropiane”, Komisioni miratoi nisma të reja të forcuara për të përkrahur zhvillimin politik dhe ekonomik të Ballkanit Perëndimor, duke ndihmuar shpejtimin e progresit të tyre në rrugën drejt anëtarësimit në BE.

ÇFARË ËSHTË MARRËVESHJA E STABILIZIM-ASOCIIMIT?

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) është një marrëveshje ligjore ndërkombëtare ndërmjet vendit nënshkrues dhe Bashkimit Evropian. Funkzioni i saj është të vendosë kuadrin ligjor për bashkëpunim ndërmjet të dy palëve dhe adoptimin gradual të standardeve evropiane, të tilla si: kushtet që duhet të plotësojnë mallrat, shërbimet dhe kapitalet vendase që të mund të lëvizin lirisht në Bashkimin Evropian, apo rregullat që përcaktojnë se si duhet të zhvillohet konkurrenca në treg.

Një nga karakteristikat kryesore të MSA-së është përqendrimi në krijimin dhe forcimin e parimeve demokratike dhe bashkëpunimit me vendet e rajonit të Ballkanit. Bashkëpunimi

Rajonal synon vendosjen e një rrjeti marrëveshesh dy dhe shumëpalëshe ndërmjet vendeve të Ballkanit në fushën tregtare, ekonomike, ligjore, politike etj. Kjo qasje ka për qëllim krijimin dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet vendeve ballkanike, duke sjellë frymën e bashkëpunimit dhe pajtimit, për të mënjanuar tensionet dhe nxitur zhvillimin reciprok.

Përfitimet më të rëndësishme, të drejtpërdrejta nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit janë në fushën e tregtisë, duke lejuar një hyrje më të lirë të prodhimeve vendase në tregun e përbashkët evropian.

QYTETARËT E EVROPËS

Të gjithë Evropianët marrin pjesë në ndërtimin e Evropës: shtëpiakët, që mbushin shportën me produktet nga të katër cepat a Bashkimit Evropian; motoristët që zgjedhin makinën që iu përshtatet pa u preokupuar për prejardhjen e saj; punëtorët që punësohen nga një firmë e komunitetit në shtetin e tyre ose në shtetin që ka origjinën firma; biznesmenët që vrapojnë përmes kufijve për të nënshkruar marrëveshje me partnerët e huajë; studentët që studiojnë në një vend partner për të mësuar gjuhën e tij dhe kështu të përmirësojnë edukimin e tyre; pensionistët nga një shtet verior, që e kalon gjithë vitin duke ëndërruar për të kaluar pushimet në një shtet të Evropës Jugore; qytetari i një prej këtyre vendeve, që aspiron të studiojë nga afër stilin e jetës dhe kulturën e fqinjëve të tij, etj. Të gjithë këta marrin pjesë në ndërtimin e kësaj shtëpie të madhe që quhet Evropë. Përdorimi i të mirave materiale, shërbimeve dhe mundësive të ofruara nga partnerët tanë Evropianë kontribuojnë në ecjen përpara të Evropës. Sa herë që zgjedhin këtë apo atë prodhim ose shërbim në mënyrë të pavetëdijshme kontribuojmë në ndërtimin e Evropës.

Procesi i ndërtimit e ka vënë Evropën në qendër të arenës botërore . Ne jemi të pranishëm në një moment të madh në historinë e njerëzimit, me vetëdije të plot ose jo, në një eksperiencë unike që do të lerë gjurmët e saj në historinë e planetit për një kohë të gjatë, siç është unifikimi gradual dhe i lirë i kombeve, të cilët deri vonë ishin armiq me njeri-tjetrin.

Thelbi i kësaj eksperience është liria: liria e lëvizjes së individëve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, liria e shteteve dhe popujve të tyre për t'u bërë pjesë ose jo në këtë Bashkim. Liria politike dhe ekonomike garantojnë ndërtimin e sigurt të Evropës e cila shpejt ose vonë do të akomodojë të gjithë popujt e Evropës.

Qytetarët që i duan këto liri janë mbështetës të vetëdijshëm ose të pavetëdijshëm të ndërtimit të Evropës.

Në qoftë se je qytetar i Bashkimit Evropian, mund të udhëtosh, të studiosh dhe të punosh në çdo vend të Bashkimit Evropian. Gjithnjë e më shumë, BE po punon që t'i sigurojë qytetarëve të vet më shumë liri lëvizjeje, si një nga të drejtat themeltare të tyre, dhe të mënjanojë çdo lloj diskriminimi në bazë kombësie.



Në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian mund të udhëtohet pa patur pasaportë me vete, pa hasur pengesa doganore në kufi. Me pak përjashtime, mund të blihet çdo gjë dhe të transportohet në vendbanimin përkatës.

Bashkimi Evropian nuk vendos se çfarë mësohet në shkollë, por ama ai siguron që kualifikimet profesionale dhe arsimore të njihen në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian.

Bashkimi Evropian punon që nëpërmjet skemave të shkëmbimit dhe të partneriteteve, t'i sigurojë mundësi për t'u shkolluar çdo qytetari brenda dhe jashtë vendit, duke shmangur kështu procedurat burokratike.

MALI I ZI dhe BASHKIMI EVROPIAN

Edhe pse që nga koha e RSF të Jugosllavisë Mali i Zi ka qenë pjesë e procesit të bashkëpunimit me Bashkimin Evropian, marrëdhëniet më të afërta në mes Malit të Zi dhe Bashkimit Evropian fillojnë pas referendumit për pavarësinë e Malit të Zi më 21 maj 2006. Komisioni Evropian në korrik 2007 përgatiti propozimin e direktivës për negociata drejt Këshillit, i cili më 24. korrik 2007, me procedurë të shkurtuar, miratoi dhe autorizoi Komisionin Evropian që të hapë, gjegjësisht vazhdojë negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me Malin e Zi.

Këto negociata kanë filluar në tetor 2005, kur Mali i Zi ishte pjesë e bashkësisë Serbia dhe Mali i Zi. Pas më shumë raundesh të negociatave politike dhe teknike, Marrëveshja mbi Stabilizimin dhe Asocimin e Malit të Zi në Bashkimin Evropian është parafuar më 15 mars 2007, në Podgoricë. Me nënshkrimin e Marrëveshjes mbi Stabilizim-Asocimin më 15 tetor 2007 në Luksemburg, si dhe me nënshkrimin e Marrëveshjes së përkohshme për tregtinë dhe çështjet e ngjashme, Mali i Zi është futur thelbësisht në procesin e Stabilizimit dhe Asocimit në BE.

Kuvendi i Malit të Zi më 27 dhjetor 2007 miratoi dokumentin e ri, Rezolutën mbi përmbushjen e detyrimeve të Malit të Zi në kuadër të Marrëveshjes mbi Stabilizim - Asociimin.

Mali i Zi paraqiti kërkesën për anëtarësim në Bashkimin Evropian më 15 dhjetor të vitit 2008. Kërkesa e nënshkruar nga zyrtaret me te larte shtetërore të Malit të Zi iu dorëzua presidentit të Francës, Nicolas Sarkozy, vendi i te cilit mban kryesinë e radhës të Bashkimit Evropian.



Me 23 prill 2009, Bashkimi Evropian, në nivelin e këshillit të ministrave të bujqësisë dhe peshkimit të mbledhur në Luksemburg, pranoi në parim kërkesën e Malit të Zi për statusin kandidat. Marrëveshja e arritur disa javë më parë në nivelin e përfaqësuesve të përhershëm të vendeve anëtare të BE-së në Bruksel u miratua në këshillin e parë, pa pritur këshillin e ministrave të jashtëm që mblidhet në fillim të javës që vjen.

Sipas procedurës, vendet anëtare i kërkuan Komisionit të nisë hartimin e opinionit për gatishmërinë e vendit për të fituar statusin kandidat. Procesi i cili mesatarisht zgjat rreth një vit, në rastin e Kroacisë dhe Maqedonisë, vendet e fundit që kanë fituar këtë status, ka marrë disa muaj më shumë. Nëse gjithçka shkon mirë për Malin e Zi, siç deklaroi Komisioneri evropian për zgjerimin Olli Rehn para pak kohësh, procesi pritet të përmbyllet nga mesi i vitit 2010. Në komunikatën për shtyp të lëshuar nga Presidenca çeke e BE-së, pas vendimit në këshillin e ministrave të bujqësisë dhe të peshkimit, përsëritet se ky akt konfirmon perspektivën evropiane të rajonit të Ballkanit.

Marrja e statusit realizohet vetëm pasi Komisioni Evropian të hartojë një opinion pozitiv, në bazë të të cilit vendet anëtare kanë sërish të drejtën e votës. Dëshmitë e qarta të zbatimit të detyrimeve në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, përfshirë pjesën tregtare të saj, janë elementi kryesor për marrjen në konsideratë të aplikimit për anëtarësim të një vendi.